



Datë: 27/092021

Nr. 26 Prot.

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
Për dijeni: Drejtorisë së Policisë Rrugore
Subjekti: Kërkesë për mbështetje për organizmin e garës sportive
ndërkombëtare me autovetura "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill
Climb 2021"

Të nderuar Zotërinj,

Klubi i Automobilit të Shqipërisë (ACA), me autoritetin e Federatës Shqiptare të Sporteve të Automobilizimit (FASA), do të organizojë në datat 11 Shtator - 12 Shtator 2021, aktivitetin e garës sportive ndërkombëtare të shpejtësisë me autovetura, "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021". Ky është viti i 8-të që kjo garë ndërkombëtare zhvillohet në territorin e Bashkisë Krujë.

"Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" është garë sportive me autovetura e regjistruar zyrtarisht në Kalendarin Kombëtar Sportiv të FASA e cila ka të drejtën e organizimit të saj.

Kjo garë është gjithashtu e regjistruar dhe është e vlefshme për kampionatin e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizimit (FIA www.fia.com) për Zonën e Europës Qëndrore (CEZ-FIA <http://www.cez-motorsport.com/2021/cez-hill-climb/>). Në garë do të marrin pjesë mbi 30 garues nga Shqipëria, Italia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Sllovenia, Kroacia, etj. Klubi ACA dhe Federata FASA, për 6 vjet, organizojnë garën sportive ndërkombëtare në territorin e Bashkisë Krujë në Rrugën e Malit, në segmentin rrugor Mali i Krujës - Sarisalltik.

Aktiviteti sportiv automobilistik do të zhvillohet në dy ditë:

- datë 11 Shtator 2021, ditën e shtunë, ora 08:30 deri në orën 14:00, do të zhvillohet sesioni i provave zyrtare;
- datë 12 Shtator 2021, ditën e dielë, nga ora 09:00 deri në orën 15:00 do të zhvillohet sesioni i garave.

Për sa më sipër, me anë të kësaj shkrese kërkojmë mbështetjen Tuaj dhe të institucionit që Ju drejtoni në organizimin e këtij event, sipas të gjithë procedurave përkatëse. Paraprakisht po Ju konfirmojmë se i jemi drejtuar për mbështetje dhe kemi vënë në dijeni Bashkinë e Krujës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe shërbimin e zjarrfikëseve.

Gjej rastin të shpreh vlerësimin e Klubit ACA dhe Federatës FASA për kontributin e dhënë nga institucioni juaj në zhvillimin e edicioneve të

MEMBER OF

